




REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: **IPK/09072024/DI**
Datë: **09.07.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, si dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Vlerësimi i trajtimit dhe procedimit të rasteve të trafikimit me narkotikë
Referenca	- 03/2024
Data e inicimit	- 27.02.2024
Data e raportimit	- 09.07.2024
Arsyet e inicimit	- Me kërkesë të Departamentit të Hetimeve të IPK-së, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar Departamentin e Inspektimit të IPK-së që të realizojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Drejtorinë e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë, me theks të veçantë në dy Njësitë e Hetimit të Narkotikëve (Prizren dhe Gjakovë), për të vlerësuar trajtimin e rasteve që lidhen me trafikimin me narkotikë. Kërkesa për këtë inspektim ka pasqyruar shqetësimet nga burimet e informacionit se në këto njësi ka probleme mbi trajtimin e rasteve dhe administrimin e provave dhe dosjeve. Inspektimi është fokusuar te raportimi e regjistrimi i rasteve, veprimet hetimore, bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit, administrimi i provave, menaxhimi kohës, mbajtja dhe mirëmbajtja e evidencave dhe dosjeve. Përmes inspektimit është synuar të vlerësohet: nëse legjislacioni zbatohet për të arritur qëllimet, nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive, nëse njësitë hetimore janë të angazhuara dhe të përkushtuara në hetimin dhe zbulimin e kryesve të veprave penale, dhe nëse abuzohet në përmbushjen e detyrave e përgjegjësiëve gjatë trajtimit të rasteve hetimore.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave në hetimin dhe procedimin e rasteve në Prokurorinë e Shtetit, - Identifikimi dhe vlerësimi i i mbajtjes dhe mirëmbajtjes së evidencave dhe dosjeve.
Metodologjia e inspektimit	- Gjatë realizimit të punës inspektuese është aplikuar metodologjia, si: a) Janë realizuar takime - intervista me bartësit e funksioneve, si: - Drejtori i Drejtorisë për Hetimin Trafikimit të Narkotikëve, - Shefi i Njësisë së Hetimit të Narkotikëve-Prizren, - Shefi i Njësisë së Hetimit të Narkotikëve-Gjakovë; b) Janë inspektuar dhe kontrolluar: - Evidenca fizike dhe elektronike e rasteve penale, - Dosjet hetimore të 64 rasteve të DHTN-Prizren dhe Gjakovë; c) Janë siguruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike, përfshirë: - Raportet vjetore,

	<ul style="list-style-type: none"> - Lista e burimeve njerëzore, - Lista e rasteve hetimore.
Subjekti	- Njësitë e Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë Sektori i Njësive Rajonale për Hetimin e Narkotikëve Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë.
Afatet e inspektimit	- Fillimi i inspektimit: 28.02.2024, - Përfundimi: 02.03.2024, - Periudha e mbulimit: 2015-2023.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Kodi i Procedurës Penale, - Kodi Penal i Republikës së Kosovës, - Ligji për Policinë, - PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit, - PSO - Drejtoria e Hetimit të Krimeve të Trafikimit me Narkotikë.
Ekipi realizues	- Kushtrim Jonuzi, inspektor, - Xhavit Fetahaj, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK
Datë	- 09.07.2024



Shkurtesat

AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
DHTN	Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale Policore
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PSO	Procedura Standarde e Operimit

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✦ Bazuar në dosjet e siguruar nga inspektimi, janë identifikuar dobësi lidhur me administrimin e disa prej tyre, meqë kanë mungesë të raporteve, procesverbaleve, planeve, shkresave dhe formularëve, duke i bërë ato të mangëta dhe me mungesë informacionesh.
- ✦ Pasqyrohet një efektivitet dhe efikasitet i ulët i trajtimit të disa prej rasteve përgjatë viteve 2015-2021, ku nga mosveprimi dhe neglizhenca, hetimet janë zhagitur dhe bartur nga viti në vit, ku për pasojë ato janë mbyllë nga Prokuroria e Shtetit për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.
- ✦ Janë identifikuar raste kur nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme hetimore në zbatim të autorizimeve policore dhe urdhrave të autoriteteve të drejtësisë, që kryesisht lidhen me zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, si dhe intervistimit të palëve të përfshira, duke dështuar kështu në hetimin efikas dhe efektiv të rasteve.
- ✦ Një pjesë e dëshmive që lidhen me një numër rastesh janë hasur jashtë Dhomës së dëshmive të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, të mbetura në një nga zyrat e kësaj Njësie pa ndonjë proces të dokumentuar të pranimit-dorëzimit të tyre dhe në kundërshtim me Procedurat Standarde të Operimit.



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar që raportimi tek Prokurori i Shtetit, mbi veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, praktikohet përmes raporteve njoftuese, konform nenit 71, paragrafi 6 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale.
2. IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se për secilin rast përpilohet plani i hetimeve, konform kapitullit VIII, paragrafi 8.2.8 të Procedurës Standarde të Operimit- Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (PK-DH/06-PSO.14, datë 07.02.2022).
3. IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se për secilin rast hetimor që përcillet me masa të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, raportimi mbi zbatimin e tyre të kryhet rregullisht dhe në mënyrë të plotë për secilën prej masave të urdhëruara, konform nenit 90 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale.
4. IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se ndërmarrin veprimet e nevojshme në kompletimin e dosjeve me dokumentet e nevojshme, si: vërtetimet për konfiskimin e sendeve, listat e evidencës së dëshmive, si dhe fotografitë e sendeve të konfiskuara.
5. IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se për kontrollet e shtëpive, objekteve përcjellëse dhe automjeteve të të dyshuarve, të lejuara me urdhra verbal të autoriteteve përgjegjëse, merren urdhëresat retro-aktive për fuqizimin e kontrolleve të tilla.
6. IPK i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të ushtrojë kontroll mbi hetuesit, për t'u siguruar që testimi fushor i substancave të dyshuara narkotike me peshë deri në 3 gram dhe rezultatet e tij dëshmohen me raporte dhe fotografi.

7. *IPK i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të ushtrojë kontroll mbi hetuesit, për t'u siguruar që brenda fazës së hetimeve intervistohen të gjithë të dyshimtit dhe dëshmitarët potencial, drejt sigurimit të informatave më të zgjeruara mbi rastet (po ashtu dosjet e rasteve të përmbajnë procesverbalet e intervistimit të palëve, nëse veprime të tilla janë ndërmarrë).*
8. *IPK i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që në të ardhmen të sigurohet se dëshmitë dhe sendet e konfiskuara si rezultat i veprave penale, të jenë të sistemuara në Dhomën e dëshmive. Në të kundërtën, kur hasen situata të tilla, të raportohen me qëllim që të mos abuzohet me to.*
9. *Me gjithë faktin se nga viti 2021 ka filluar një punë me efektive në trajtimin e rasteve, IPK-ja i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, të kujdeset që rastet e iniciuara të trajtohen në kohë optimale, duke ruajtur vazhdimësinë e hetimeve edhe kur ka ndryshime a lëvizje në strukturën e personelit brenda Njesisë.*
10. *IPK i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të sigurohet se kërkesat e Prokurorit të Shtetit për sigurimin e informacioneve në drejtim të plotësisimit të kallëzimeve penale, trajtohen më me kujdes dhe se pavarësisht rezultateve, veprimet shitesë pasqyrohen më detajisht në raporte.*
11. *IPK-ja i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të ushtrojë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se dosjet e tyre përmbajnë dokumente me të dhëna të përputhshme, të qëndrueshme dhe të besueshme, duke iu referuar vërejtjeve të pasqyruara në paragrafët 9 dhe 12 të Kapitullit - Përfundime të këtij Raporti.*

1. Rregullat dhe procedura e trajtimit dhe procedimit të rasteve

1.1. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave gjatë hetimit dhe procedimit të rasteve në Prokurorinë kompetente nga njësitë e DHTN-së, IPK ka përzgjedhur një mostër dosjesh hetimore për periudhën kohore nga viti 2015 deri në vitin 2023. Kontrolli i dosjeve hetimore në kuadër të Njësive të DHTN-së në Prizren dhe Gjakovë është fokusuar në rregullsinë e trajtimit të rasteve hetimore, përfshirë por duke mos u kufizuar në rregullat e inicimit të rasteve, veprimet e nevojshme hetimore, zbatimin e autorizimeve të Prokurorit të Shtetit, zbatimin e urdhërave të Prokurorisë/Gjykatës mbi masat të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, kompletimin e dosjeve hetimore dhe efikasitetin policor në hetimin e rasteve nga iniciimi deri në procedimin e tyre në organin e Prokurorit të Shtetit.

1.2. Sipas KPP të vitit 2012 është e paraparë që “Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzetë e katër (24) orëve t’i dorëzojë një raport policor Prokurorit të Shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale”¹. Po ashtu, edhe me KPP të vitit 2022 është e paraparë që “Posa policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar, është duke u kryer, apo do të kryhet së shpejti, policia është e detyruar që menjëherë të njoftojë Prokurorin e Shtetit dhe t’i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve”². Nga dosjet e rasteve penale të kontrolluara në DHTN-Njësia në Prizren dhe Gjakovë, është gjetur se hetuesit në shumicën e rasteve nuk kanë aplikuar praktika të raportimit me shkrim për Prokurorin e Shtetit brenda afatit prej 24, respektivisht 72 orëve, siç është e përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi, të cituara si më lartë. Bazuar në raporte policore, rezultojnë që komunikimi me prokurorët kujdestar është aplikuar kryesisht verbalisht. Në raste kur hetuesit e këtyre njësive brenda afatit 24, respektivisht 72 orë kanë parashtruar kërkesa në Prokurori për zbatimin e masave të fshehta të hetimit, apo ekzaminimin e dëshmive të sekuestruara përkohësisht, në to kanë përshkruar edhe informata mbi rrethanat e rastit. DHTN-Njësia në Prizren në 31 nga 46 raste nuk ka njoftuar me shkrim Prokurorin e Shtetit, meqë një gjë e tillë është kryer verbalisht, derisa në 15 raste të tjera, raportimi është kryer me raport, apo përmes kërkesave për zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, apo ekzaminimit të dëshmive. DHTN-Njësia në Gjakovë në 11 nga 18 raste nuk ka njoftuar me shkrim Prokurorin e Shtetit, meqë një gjë e tillë është kryer verbalisht.

1.3. Planifikimi është fazë e veprimit operativ hetimor mjaft me rëndësi, përmes të cilit parashihen dhe renditen veprimet e nevojshme operative hetimore drejt një menaxhimi efikas dhe nxjerrjes së rezultateve cilësore në hetimin e rasteve. Me PSO të Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotik është paraparë që për secilin rast hetuesit duhet të përpilojnë Planin e hetimit³, që pas analizimit e shqyrtimit, aprovohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Inspektimi vë në pah se:

- DHTN-Njësia në Prizren në 18 nga 46 raste nuk ka hartuar planet e hetimit, derisa në 22 raste ka hartuar planet në faza të mëvonshme, pas transferimit të rasteve tek hetuesit tjerë,
- DHTN-Njësia në Gjakovë në të gjitha rastet e kontrolluara (18 nga 18) nuk ka hartuar planet e hetimit.

¹ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, neni 70, paragrafi 4.

² Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 71, paragrafi 6.

³ PSO-Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotik, kapitulli VIII, në pikën 8.2.8 përcakton që “Plani i hetimit përmban, por nuk është i kufizuar përshkrimin e shkurtër mbi mbledhjen e informatave, dyshimin për veprën penale, caqet e hetimit, mënyrën e hetimit të rastit duke përfshirë veprimet hetimore, përdorimin e masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, përdorimin e pajisjeve teknike, afatet kohore mbi hetimin e rastit, përgjegjësitë për veprimet hetimore si dhe metoda tjera, varësisht prej rrjedhshmërisë së rastit”.

	<p>1.4. Gjatë hetimit për zbulimin e veprave penale kundër narkotikëve, me KPP është paraparë aplikimi i masave të fshehta të hetimi dhe vëzhgimit. Andaj, Gjyqtari i Procedurës Paraprake, në bazë të kërkesës me shkrim të Prokurorit të Shtetit mund të urdhërojë secilën nga masat e parapara me KPP, dhe zyrtari i autorizuar i policisë lidhur me zbatimin e masave duhet të raportoj me shkrim jo më larg se 60 ditë nga dita e lëshimit të urdhrimit. Sipas dosjeve të kontrolluara, Gjykata në raste të caktuara kishte lëshuar urdhra mbi zbatimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, përkatësisht: fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike, hetim i fshehtë, blerje e simuluar të ndonjë sendi si dhe përgjimin e telekomunikimeve. Inspektimi vë në pah se në tetë (8) nga 64 mostra të kontrolluara në dy njësitë (Prizren e Gjakovë) ku janë urdhëruar masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, ka rezultuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - DHTN-Njësia në Prizren, në 6 nga 46 mostra ka zbatuar masa të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, prej të cilave, në 2 raste nuk ka ndonjë shkresë, raport, apo material tjetër që dëshmon se hetuesit e rastit kanë raportuar me shkrim për aktivitetin e zbatimit e masave të urdhëruara, kurse në 4 raste përveç raportimit mbi zbatimin e masës “përgjim i telekomunikimeve”, nuk ka raportim mbi zbatimin edhe të masave tjera të urdhëruara (fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike, hetim i fshehtë, blerje e simuluar të ndonjë sendi). - DHTN-Njësia në Gjakovë, në 2 nga 18 mostra ka zbatuar masa të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, prej të cilave, në 1 rast përveç raportimit mbi zbatimin e masës “përgjim i telekomunikimeve”, nuk ka raportim mbi zbatimin edhe të masave tjera të urdhëruara (fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, monitorim i fshehtë të bisedave në vende publike dhe private), kurse në 1 rast ka pasur raportim mbi zbatimin e masave të lejuara. <p>1.5. Provat dhe dëshmitë që lidhen me rastet e hetimit të narkotikëve duhet të trajtohen sipas KPP⁴ dhe rregullave që parashihen me PSO. Me PSO të Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotik është paraparë që të gjitha njësitë/sectorët janë të obliguar të mbajnë evidenca për provat, dëshmitë që kanë në ruajtje të përkohshme dhe për çdo pranim dorëzim të provave/dëshmimeve mes njësive policore duhet të plotësohet formulari i zinxhirit të ruajtjes. Po ashtu, kur provat dhe dëshmitë merren nga palët, në rast se dihet pronari, palës i lëshohet Fletë konfiskimi⁵. Gjatë kontrollit të dosjeve, inspektimi ishte fokusuar nëse evidencat mbi provat dhe dëshmitë që lidhen me to, janë në pajtim me rregullat dhe procedurat në fuqi. Nga inspektimi i 64 mostrave në dy njësitë (Prizren dhe Gjakovë) rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga 46 mostra të inspektuara në DHTN-Njësia në Prizren, 16 prej tyre nuk kanë vërtetime mbi konfiskimin e sendeve (fletë konfiskimet), 11 mostra nuk kanë Listën e evidencës së dëshmimeve dhe 14 mostra nuk kanë të bashkëngjitur fotografi mbi dëshmitë e konfiskuara. - Nga 18 mostra të inspektuara në DHTN-Njësia në Gjakovë, 5 prej tyre nuk kanë Listën e evidencës së dëshmimeve. <p>1.6. Gjatë kontrollit të dosjeve hetimore janë identifikuar raste kur dy njësitë e inspektuara kanë realizuar kontrole të shtëpive, objekteve përcjellëse dhe automjeteve të të dyshuarve, në bazë të urdhrave verbal të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake. Kur Policia ndërmer kontroll pa urdhër të shkruar të gjykatës, brenda afatit ligjor, pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë Prokurorit të Shtetit, që më pas Gjykata ta aprovojë në mënyrë retro-aktive kontrollin dhe sekuestrumin e</p>
--	---

⁴ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale neni 70, paragrafi 3 dhe Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale- neni 71, paragrafi 5 përcakton “Për veprimet të cilat i ndërmarrin dhe për faktet dhe rrethanat e konstatuara nga hetimet e tyre, policia përpilon procesverbal, fotografi ose shënim zyrtar”

⁵ PSO - Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, kapitulli XII - Provat dhe dëshmitë.

	<p>përkohshëm⁶. Provat e marra gjatë kontrollit, pa lejen e gjykatës janë të pa pranueshme, nëse kontrollimi nuk merr aprovim retro-aktiv gjyqësor. Inspektimi vë në pah se në dy (2) raste të trajtuara nga DHTN-Njësia në Prizren dhe në dy (2) të tjera të trajtuara nga DHTN-Njësia në Gjakovë, edhe pse janë realizuar kontrollet e shtëpive dhe objekteve përcjellëse sipas urdhrave verbal të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, nuk janë siguruar Urdhëresa retroaktive për fuqizim të kontrolleve të tilla.</p> <p>1.7. Testimi fushor për ekzaminim të substancave të dyshimta narkotike që aplikohet për rastet e kapjes së substancave të dyshimta narkotike me peshë deri në 3 gram, si procedurë aplikohet nga njësitë për hetimin kundër narkotikëve, derisa sasitë e kapura mbi këtë peshë ekzaminohen nga AKF. Lidhur me këtë lloj testimi, PSO-Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë tek kapitulli XII (Provat/dëshmitë), në paragrafin 12.10 përcakton që “Hetuesit e DHTN pas përfundimit të trajnimeve të nevojshme dhe pajisjes me mjete, aparate për ekzaminim, mund të kryejnë teste/ekzaminime të substancave narkotike dhe rezultatet e tyre t’i paraqesin para prokurorisë kompetente”. Ky paragraf më tutje përcakton që “Hetuesit e DHTN mund të kryejnë teste/ekzaminime të substancave narkotike deri në 3 gram për njësitet tjera nga stacionet policore në regjionet përkatëse”. DHTN-Njësia në Prizren në rastet e gjetjes dhe konfiskimit të substancave të dyshuar narkotike deri në 3 gram, kryen testimin fushor për ekzaminimin e përmbajtjes së tyre, duke aplikuar metodën M.M.C International B.V Canabis Test. Testimet e kryera me këtë procedurë, Njësia i përshkruan në Kallëzim Penal apo në Raport të Veçantë, por nuk aplikon hartimin e raporteve me fotografi lidhur me detajet e ekzaminimit dhe rezultatet e testimit, që do të mund t’iu bashkëngjiten dosjeve. Në 13 raste, edhe pse në Kallëzim Penal apo në Raport të Veçantë ceket se testimi fushor i substancës së dyshuar narkotike kishte rezultuar pozitiv, në dosje nuk është hasur dokumenti që dëshmon testimin e kryer. Nga kontrolli i dosjeve të DHTN-Njësia në Gjakovë, është hasur që ekzaminimet edhe për sasitë e kapura deri në 3 gram realizohen nga AKF.</p> <p>1.8. Në kuadër të veprimeve fillestare të Policisë, Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (i mëparshëm) në nenin 70 ka paraparë veprimet hetimore policore, përfshirë edhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, apo të dyshuarve të mundshëm në pajtim me nenin 73 të këtij Kodi. Edhe Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale (i ri) në nenin 71 (Autorizimet e Policisë), parasheh veprimet hetimore policore, përfshirë edhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, apo të dyshuarve të mundshëm në pajtim me nenin 74 të këtij Kodi. Nga kontrolli i 46 mostrave të DHTN-Njësia në Prizren, në 12 prej tyre ka raste kur nuk janë hasur procesverbalet mbi intervistimin e të dyshuarve dhe dëshmitarëve, apo kur nuk janë intervistuar të gjithë dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm me gjithë faktin se identiteti i tyre ka qenë i njohur.</p> <p>1.9. Gjatë inspektimit në DHTN-Njësia në Prizren, në njërën prej zyrave të saj janë hasur disa dëshmi që lidhen me rastet të vjetra hetimore nga viti 2012 e tutje, të cilat kryesisht kanë qenë pronë e të dyshuarve. IPK fillimisht ka analizuar bazën ligjore mbi trajtimin dhe ruajtjen e dëshmimeve dhe ka vërejtur se ato është dashur të jenë në Dhomë të dëshmimeve, konform rregullave të përcaktuara me PSO-në e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotik⁷, e cila në kapitullin XII, përcakton që “të gjitha provat/dëshmitë e sekuestruara nga sektorët e nivelit qendror duhet të shkojnë në</p>
--	---

⁶ Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale- neni 108, paragrafi 2 dhe 3, kurse me Kodin nr. 08/L-123 të Procedurës Penale, neni 110, paragrafi 5 dhe 6 përcakton që: Policia mund të zbatojë kontrollin e personit pa urdhër, ose pa praninë e dëshmitarëve kur ekzekuton aktvendimin për sjelljen forcërisht të personit ose kur bën arrestimin e tij, nëse ekziston dyshim i bazuar se personi mban armë apo ndonjë mjet për sulm ose kur mund të mënjanojë, fshehtë apo asgjësojë sendet të cilat nga ai duhet të merrin si provë në procedurë penale; kur Policia ndërmeret kontrolli pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) orësh, pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë Prokurorit të Shtetit dhe Gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovim retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

⁷ Referencë: PK-DH/06-PSO.14, datë 07.07.2022.

Dhomën Qendrore të dëshmime në DPP, kurse provat/dëshmitë e sekuestruara nga njësitë rajonale dorëzohen në dhomat e dëshmime të DRP-ve përkatëse. Mënyrën e ruajtjes e ka rregulluar edhe PSO- Dhomat e dëshmime- Vendosja, trajtimi dhe ruajtja e sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, në nivelin lokal e qendror të Policisë së Kosovës⁸. IPK duke vërejtur këtë dukuri, ka kërkuar sqarime mbi mbajtjen e dëshmime në zyrë dhe jo në Dhomë të dëshmime, që lidhen me 12 raste të periudhës nga 2012-2019. Lidhur me këtë, inspektorët janë njoftuar nga menaxhmenti aktual i se këto dëshmi janë hasur në zyrë në momentin kur edhe është ndërruar menaxhmenti.

1.10. Pasi janë hasur këto dëshmi, IPK ka siguruar evidencat për dëshmitë dhe rastet penale që lidhen me to. Janë kontrolluar dosjet e nëntë (9) rasteve, duke verifikuar përputhshmërinë e procedimit të dëshmime në shkresat e lëndëve. Gjatë kontrollit të dosjeve në kuadër të këtyre rasteve janë evidentuar mangësi që lidhen me evidencat dhe përshkrimin e dëshmime në kuadër të shkresave të lëndëve, dhe atë si: mungesë e numrave serik të dëshmime në tre (3) raste, mos evidentim në një (1) rast të dëshmime në Vërtetimin e sendeve të konfiskuara, mos evidentim në katër (4) raste të dëshmime në Evidencën e dëshmime dhe mos përshkrim në dy (2) raste të dëshmime në përmbajtje të kallëzimeve penale.

1.11. Nga raportet e DHTN-Njësia në Prizren vërehet se deri në vitin 2021 ka pasur grumbullim të rasteve nën hetim nga vitet e kaluara, por që menaxhmenti aktual ka ndërmarrë hapa konkret në përmylljen e tyre, qoftë me kallëzim penal apo raport të veçantë. Në vitin 2021, numri i rasteve të bartura nga vitet e kaluara ka arritur në kuotën e 37% të numrit të përgjithshëm të rasteve të ngarkuara për këtë vit. Brenda këtij viti, janë përfunduar hetimet për 98% të rasteve të bartura. Në vitin 2022, numri i rasteve të bartura ka qenë 10% e totalit të rasteve të ngarkuara, derisa në vitin 2023, kjo kuotë sillet më 11%. Analiza e indikatorëve të performancës së DHTN-Njësia në Gjakovë pasqyron se kjo Njësi në vitin 2021 nuk ka pasur raste të grumbulluara nga vitet e kaluara. Në vitin 2021, numri i rasteve të bartura nga vitet e kaluara është në kuotën 0, derisa në vitin 2022 dhe 2023, numri i rasteve të bartura nga viti paraprak është 10%, përkatësisht 7% e totalit të përgjithshëm të rasteve të ngarkuara.

Tabela 1 dhe 2: Paraqitja tabelore e indikatorëve të performancës së DHTN-Prizren dhe Gjakovë (2021-2023)

Administrimi i rasteve NJHTN - Prizren	2021			2022			2023		
	Bartur	Të vitit	Total	Bartur	Të vitit	Total	Bartur	Të vitit	Total
Numri i rasteve	49	83	132	8	80	88	8	64	72
Raste të përfunduara	48	76	124	7	73	80	6	59	65
- Me kallëzim penal	32	70	102	4	67	71	2	58	60
- Me raport të veçantë	16	6	22	3	6	9	4	1	5
Raste në proces (bartur)	1	7	8	1	7	8	2	5	7

Administrimi i rasteve NJHTN - Gjakovë	2021			2022			2023		
	Bartur	Të vitit	Total	Bartur	Të vitit	Total	Bartur	Të vitit	Total
Numri i rasteve	0	48	48	4	35	39	2	27	29
Raste të përfunduara	0	44	44	4	33	37	2	26	28
- Me kallëzim penal	0	43	43	4	32	36	1	24	25
- Me raport të veçantë	0	1	1	0	1	1	1	2	3
Raste në proces (bartur)	0	4	4	0	2	2	0	1	1


⁸ Referencë: ZDPO-02/008/14, datë 15.05.2014.

1.12. Duke marrë si shkas numrin e madh të rasteve të bartura në kuadër të DHTN-Njësia në Prizren, IPK është interesuar të njihet me efikasitetin lidhur me hetimin e rasteve të narkotikëve, duke vënë theksin te analiza e kohëzgjatjes së hetimit brenda njësisë nga inicimi i rastit e deri në procedimin e Kallëzimit Penal apo Raportit të Veçantë në Prokurorisë së Shtetit. Për dosjet e kontrolluara është llogaritur koha e mbajtjes në hetim të rasteve në kuadër të njësisë në fjalë. Për gjashtë raste (6) kur periudha e hetimit nga Policia ka kaluar periudhën më shumë se tre (3) vite, Prokuroria e Shtetit ka marrë aktvendim për hedhjen e kallëzimeve penale për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Llogaritur mbi këtë bazë, janë evidentuar edhe raste tjera për dyshimin e së njëjtës vepër penale, ku periudha e hetimit brenda njësive të DHTN-së nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në momentin e ngritjes së Kallëzimit Penal nga Policia kalon periudhën më shumë se tre (3) vite, të cilat mund të përfundojnë me epilogun e parashkrimit të ndjekjes penale, njëjtë sikurse rastet e sipër përmendura. Nga njëzetë (20) dosje, të cilat me vite janë bartur nga viti në vit (me mbi 3 vite), është gjetur se:

- tek tre (3) prej tyre, koha e hetimit nga Policia, prej inicimit të rastit e deri në procedimin e tyre në Prokurori, ka kaluar periudhën nga 5.6 - 7.3 vite,
- tek katër (4) raste, kjo periudhë është 4.4 - 4.6 vite,
- tek 13 raste tjera është 3.3 - 4.1 vite.

1.13. Në dosjet e kontrolluara janë evidentuar katër (4) raste, kur pas dorëzimit të kallëzimeve penale nga njësia përkatëse hetimore, Prokuroria Themelore në Prizren kishte drejtuar kërkesë në adresë të Policisë për plotësimin e Kallëzimit Penal. Në raportet njoftuese për Prokurorin e Shtetit, DHTN- Njësia në Prizren kishte njoftuar se nuk ka arritur të sigurojë prova, dëshmi për zbulimin e identitetit të dyshuarve për ndriçimin e këtyre rasteve. Lidhur me këtë, në dosjet e këtyre rasteve nuk ka ndonjë shkresë, apo raport, i cili tregon për veprimet shtesë që janë ndërmarrë nga hetuesit për sigurimin e informacioneve lidhur me plotësimin e Kallëzimeve Penale.

1.14. Si rezultat i inspektimit, në këtë Raport zënë vend edhe dy gjetje, për të cilat duhet sqaruar nga menaxhmenti dhe hetuesit. Kontrolli i dosjes 2016-DHTN-..... (Njësia në Prizren) vë në pah se pas hetimit dhe zbatimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, fillimisht ndaj dy të dyshuarve, dhe më pas edhe ndaj të dyshuarit të tretë, rasti ishte proceduar në Prokurorinë Themelore në Prizren me Raport të veçantë, por në dispozitiv nuk ishte përfshirë i dyshuari i tretë, si i dyshuar në masa të fshehta. Kurse gjetja tjetër ka të bëjë me atë se në Procesverbalin e bastisjes tek rasti 2019-DHTN-..... (DHTN-Njësia në Prizren) mungon përkrahimi i dëshmitëve (1 deri 5). Përkrahimi i dëshmitëve në Raportin njoftues të hetuesit dhe në Raportin e Njësisë së Forenzikës nuk përputhet me përkrahimin e dëshmitëve në Kallëzim Penal. Pësia e përgjithshme e substancës së dyshuar narkotike në Raportin njoftues të hetuesit është 142.3 gram, kurse në Kallëzimin Penal është 116.7 gram (diferenca 25 gram).

<p>Përfundime</p> 	<p>Nga gjetjet e këtij inspektimi pasqyrohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raportimi mbi veprat penale tek Prokurori i Shtetit po aplikohet më tepër përmes formës verbale dhe dosjet në të shumtën e rasteve nuk përmbajnë raporte të shkruara njoftuese, për shkak të neglizhencës në përpilimin e tyre. 2. Dosjeve penale në shumë raste u mungojnë planet e hetimit, derisa tek një numër i konsideruar i tyre, ato janë bërë në faza të mëvonshme, pasi hetimet kanë kaluar nga një hetues tek tjetri. 3. Janë identifikuar raste kur nuk është raportuar tek Prokurori i Shtetit lidhur me zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, por edhe kur raportimet janë bërë vetëm për një pjesë të masave të lejuara. 4. Janë identifikuar një numër i konsideruar dosjesh, që u mungojnë vërtetimet për sendet e konfiskuar, Lista e evidencës së dëshmive dhe fotografitë e dëshmive të konfiskuara. 5. Pas kontrollit pa urdhër të shkruar të Gjykatës, të shtëpive, objekteve përcjellëse dhe automjeteve të të dyshuarve, në disa raste nuk janë hasur urdhëresat retro-aktive për fuqizimin e kontrolleve të tilla, duke rrezikuar që provat të jenë të pa pranueshme, meqenëse kontrollet nuk kanë marrë aprovim retro-aktiv gjyqësor. 6. Me gjithë faktin se ekzaminimi i substancave narkotike për peshat deri në 3 gram dhe mbi, ka respektuar kompetencën apo autoritetin e realizimit të tyre, rezultatet e testimit fushor kur kanë rezultuar pozitive, shpesh ato nuk janë dokumentuar me raporte apo fotografi. 7. Dosjet në shumë raste nuk përmbajnë procesverbalet e intervistimit të palëve të përfshira në veprat penale të trafikimit me narkotikë, por edhe nuk dokumentojnë se intervistat janë zhvilluar me të gjithë të dyshimtët dhe dëshmitarët, megjithëse identiteti i tyre shpesh ka qenë i njohur (ditur). 8. Lidhur me një numër rastesh të administruara nga DHTN-Njësia në Prizren nuk është ndjekur rregullisht për vendosjen e dëshmive në vendet e veçanta për ruajtje (dhomë të dëshmive). 9. Janë hasur dobësi në administrimin e evidencave të dëshmive që janë hasur në një prej zyrave të DHTN-Njësia në Prizren, që pasqyrohen përmes mungesës së numrave serik në disa prej dëshmive, mos evidentimit të dëshmive në Vërtetimin e sendeve të konfiskuara dhe në Evidencën e dëshmive, si dhe mos përshkrimit të dëshmive në përmbajtje të kallëzimeve penale. 10. Një numër i konsideruar i rasteve të trajtuara nga DHTN-Njësia në Prizren nuk janë hetuar dhe administruar me efektivitet dhe efikasitet, të cilat në mungesë të veprimeve dhe zvarritjes së tyre, janë bartur nga viti në vit, dhe për rrjedhojë ka pasur mbyllje të tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. 11. Në situata kur Prokurori i Shtetit ka kërkuar veprime tjera të drejtim të plotësimit të kallëzimeve penale, nuk janë dokumentuar mjaftueshëm veprime shtesë nga hetuesit e rasteve, si rezultat i neglizhencës dhe vjetërsimit të lëndëve. 12. Janë hasur edhe dobësi tjera në disa raste, kur në dispozitiv të raportit të veçantë nuk janë përfshirë të gjithë të dyshimtit përkundër zbatimit të masave të fshehta ndaj tyre, kur përshkrimi i dëshmive në kallëzim penal nuk përputhet me ato të raportit policor dhe forenzik, kur të dhënat mbi peshën e substancës narkotike në raporte policore nuk përputhen me atë në kallëzim penal, etj.
--	---

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore ⁹ (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar që raportimi tek Prokurori i Shtetit, mbi veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, praktikohet përmes raporteve njoftuese, konform nenit 71, paragrafi 6 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale.	-1-	Udhëheqësit e DHTN- Njësia në Prizren dhe Gjakovë do të kujdesen përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme, që Rreshterët dhe hetuesit për rastet që ndiqen sipas detyrës zyrtare, përveç raportimit verbal, Prokurorin e Shtetit ta informojnë edhe me Raporte Informuese me shkrim, siç parashihet në nenin 71, paragrafi 6 të KPP nr. 08/L-032.	Menjëherë
2.	IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se për secilin rast përpilohet plani i hetimeve, konform kapitullit VIII, paragrafi 8.2.8 të Procedurës Standarde të Operimit- Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (PK-DH/06-PSO.14, datë 07.02.2022).	-1-	Udhëheqësit e DHTN- Njësia në Prizren dhe Gjakovë, përmes mbikëqyrjes do të kujdesen që në secilin rast nën hetim nga hetuesit të përpilohet Plani i Hetimit, siç parashihet në kapitullin VIII, paragrafi 8.2.8 të Procedurës Standarde të Operimit- Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (PK-DH/06-PSO.14, datë 07.02.2022).	Menjëherë
3.	IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se për secilin rast hetimor që përcillet me masa të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, raportimi mbi zbatimin e tyre të kryhet rregullisht dhe në mënyrë të plotë për secilën prej masave të urdhëruara, konform nenit 90 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale.	-1-	Edhe pse viteve të fundit ka ngritje të nivelit në Raportim, Udhëheqësit e DHTN- Njësia në Prizren dhe Gjakovë do të rrisin nivelin e mbikëqyrjes tek rreshterët dhe hetuesit dhe do të kujdesen që në secilin rast me masa të veçanta hetimore, për secilën masë të fshehtë të urdhëruar nga Prokurori apo Gjykata, të raportohet me shkrim rregullisht tek Prokurori kompetent sipas afateve ligjore, konform nenit 90 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale.	Menjëherë
4.	IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se ndërmarrin veprimet e nevojshme në kompletimin e dosjeve me dokumentet e nevojshme, si: vërtetimet për konfiskimin e sendeve, listat e evidencës së dëshmive, si dhe fotografitë e sendeve të konfiskuara.	-1-	Udhëheqësit e DHTN- Njësia në Prizren dhe Gjakovë, përmes mbikëqyrjes do të kujdesen që në secilin rast të ndërmerren veprimet e nevojshme në kompletimin e dosjeve me dokumentet e nevojshme, si: Vërtetimi për konfiskimin e sendeve, Lista e evidencës së dëshmive, si dhe fotografitë e sendeve të konfiskuara dhe dokumente tjera. Edhe Prokurorët e Shtetit janë më të angazhuar dhe kërkojnë kompletimin e këtyre dokumenteve	K3-2024

⁹ Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 05.07.2024, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

			të rëndësishme për procedurën penale, posaçërisht pas hyrjes në fuqi të KPP-së nr. 08/L-032.	
5.	IPK u rekomandon Shefave të Njësive të Hetimit të Narkotikëve në Prizren dhe Gjakovë, që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit, për t'u siguruar se për kontrollet e shtëpive, objekteve përcjellëse dhe automjeteve të të dyshuarve, të lejuara me urdhra verbal të autoriteteve përgjegjëse, merren urdhëresat retro-aktive për fuqizimin e kontrolleve të tilla.	-1-	Sa u përket urdhëresave për aprovim retroaktiv të urdhër kontrolleve verbale apo sipas nenit 108 të KPP nr. 08/L-032, të kryera në shtëpi, objekte përcjellëse dhe prona tjera të të dyshuarve, Raporti Informues dërgohet në Prokurori brenda 48 orëve dhe kërkohet aprovimi retroaktiv nga Gjykata, mirëpo ka raste kur Gjykata e lëshon urdhëresën me shkrim mbi fuqizimin-aprovimin e bastisjes mirëpo ato urdhëresa në zarf të mbyllura mbesin në Prokurori dhe nuk përcillen në Polici. Udhëheqësit e DHTN- Njësia në Prizren dhe Gjakovë, do të kujdesen që rreshterët dhe hetuesit edhe në rastet kur Prokuroria nuk i sjell këto urdhëresa në Polici, të angazhohen më shumë në kontaktet me prokurorë, në mënyrë që këto urdhëresa me shkrim të jenë në secilën dosje të rastit kur kryhen veprime të tilla.	Menjëherë
6.	IPK i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të ushtrojë kontroll mbi hetuesit, për t'u siguruar që testimi fushor i substancave të dyshuara narkotike me peshë deri në 3 gram dhe rezultatet e tij dëshmohen me raporte dhe fotografi.	-1-	Udhëheqësi i DHTN- Njësia në Prizren, përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme do të kujdeset që Raporti i Testimit Fushor të substancës narkotike me peshë deri në 3 gram, të jetë i dokumentuar edhe me fotografi e cila fotografi do t'i bashkëngjitet Raportit me shkrim. Pengesë në këtë drejtim janë edhe çështjet me pajisjet, si fotokopjet që kemi probleme që disa vite, si dhe kompjuterët që janë bllokuar nga IT dhe nuk lejojnë qasje me pajisje tjera të jashtme për shkaqe sigurie të ndërhyrjeve në sistem kompjuterik të PK-së. Gjithsesi, rekomandimet e dhëna sa i përket kësaj çështjeje do të zbatohen.	Menjëherë
7.	IPK i rekomandon Shefit të Njesisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të ushtrojë kontroll mbi hetuesit, për t'u siguruar që brenda fazës së hetimeve intervistohen të gjithë të dyshimtit dhe dëshmitarët potencial, drejt sigurimit të informatave më të zgjeruara mbi rastet (po ashtu dosjet e rasteve të përmbajnë procesverbalet e	-1-	Udhëheqësi i DHTN- Njësia në Prizren, përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme do të insistoj që në të ardhmen të gjithë personat e dyshuar dhe dëshmitarët brenda fazës së hetimeve të intervistohen dhe të gjitha procesverbalet mbi intervistimin e tyre do të jenë në dosjen e rastit. Nga praktika përjashtim mund të ketë në rastet	Menjëherë

	<i>intervistimit të palëve, nëse veprime të tilla janë ndërmarra).</i>		<i>kur një i dyshuar në të njëjtën kohë të jetë duke u hetuar në një rast tjetër dhe për shkaqe të fshehtësisë së hetimeve të mos intervistohet në njërin rast, varësisht nga pesha e rastit. Gjithashtu, në disa raste kur arrestohen persona të rritur, apo të mitur, të dyshuar përdorues të substancave narkotike dhe zbulohet identiteti i të dyshuarit tjetër për shitje të substancave narkotike nga neni 267 i KPRK-së, prokurorët nganjëherë kërkojnë që të iniciohen raste të veçanta për arsye se deklarata e një të dyshuari ndaj një të dyshuari tjetër në të njëjtin rast nuk mund të merret si provë në Gjykatë. Gjithsesi do të bëhet përpjekje që në raste të tilla kjo të dokumentohet sa më mirë që është e mundshme duke marrë për bazë edhe rekomandimet e dhëna në këtë raport të inspektimit.</i>	
8.	<i>IPK i rekomandon Shefit të Njësisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që në të ardhmen të sigurohet se dëshmitë dhe sendet e konfiskuara si rezultat i veprave penale, të jenë të sistemuara në Dhomën e dëshmimeve. Në të kundërtën, kur hasen situata të tilla, të raportohen me qëllim që të mos abuzohet me to.</i>	-1-	<i>Sa i përket dëshmimeve këtë vit ka pengesa nga dhomat e dëshmimeve, si ajo Qendrore, ashtu edhe Rajonale. Dhoma Qendrore e dëshmimeve është e mbushur për shkak se dëshmitë e ruajtura aty nuk janë shkatërruar mjaftueshëm dhe nuk ka hapësirë të lirë për sistemimin e dëshmimeve tjera, kurse dhomat rajonale të dëshmimeve janë të vendosura në objekte policore dhe zakonisht zyrtarët policor që punojnë aty hezitojnë t'i pranojnë dëshmitë, posaçërisht të substancave narkotike të Marihuanës për shkak të erës së rëndë. Udhëheqësi i DHTN- Njësia në Prizren do të bëjë përpjekje përkundër vështirësive, që dëshmitë të mos ruhen nga hetuesit në zyre, por në vendet e përcaktuara dhe të përshtatshme për to.</i>	<i>Menjëherë</i>
9.	<i>Me gjithë faktin se nga viti 2021 ka filluar një punë me efektive në trajtimin e rasteve, IPK-ja i rekomandon Shefit të Njësisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, të kujdeset që rastet e iniciuara të trajtohen në kohë optimale, duke ruajtur vazhdimësinë e hetimeve edhe kur ka ndryshime a lëvizje në strukturën e personelit brenda Njësisë.</i>	-1-	<i>Udhëheqësi i DHTN- Njësia në Prizren, përkundër punës efektive nga viti 2021 do të bëjë përpjekje që të rritet ky efektivitet dhe rastet të trajtohen në kohë optimale sipas afateve të parapara ligjore dhe pa marrë parasysh ndryshimet në strukturë organizative vazhdimësia e hetimeve të mos ndërpritet dhe të mos ndikojë në efikasitetin e hetimeve.</i>	
10.	<i>IPK i rekomandon Shefit të Njësisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që</i>	-1-	<i>Udhëheqësi i DHTN- Njësia në Prizren, përmes mbikëqyrjes së</i>	<i>Menjëherë</i>

	<i>të sigurohet se kërkesat e Prokurorit të Shtetit për sigurimin e informacioneve në drejtim të plotësimit të kallëzimeve penale, trajtohen më me kujdes dhe se pavarësisht rezultateve, veprimet shtesë pasqyrohen më detajisht në raporte.</i>		<i>vazhdueshme nga rreshterët deri tek hetuesit, do të kujdeset që Kërkesat e Prokurorit të Shtetit për Plotësim të Kallëzimeve Penale, të trajtohen me kujdes dhe hetuesit të ndërmarrin veprimet e nevojshme në mënyrë që Raporti i Plotësimit të Kallëzimit Penal në Prokurori të dorëzohet i dokumentuar, bazuar në informacione dhe prova të besueshme të siguruara nga puna e tyre operative-hetimore.</i>	
11.	<i>IPK-ja i rekomandon Shefit të Njësisë për Hetimin e Narkotikëve në Prizren, që të ushtrojë kontrole mbi hetuesit, për t'u siguruar se dosjet e tyre përmbajnë dokumente me të dhëna të përputhshme, të qëndrueshme dhe të besueshme, duke iu referuar vërejtjeve të pasqyruara në paragrafët 9 dhe 12 të Kapitullit - Përfundime të këtij Raporti.</i>	-1-	<i>Udhëheqësi i DHTN- Njësia në Prizren do të ushtrojë kontroll tek rreshterët dhe hetuesit që në Raportet e Veçanta të përfshihen të gjithë të dyshuarit që kanë qenë nën hetim. Gjithashtu do të ushtrohet kontroll më i shtuar tek kallëzimet penale dhe Raportet e policit dhe Forenzikës, si dhe dokumentet tjera për të evituar gabimet, qoftë ato edhe teknike, për të eliminuar mospërputhjet në mes të raporteve dhe dokumenteve tjera me Kallëzimin Penal. Sa i përket peshës së substancës narkotike dallimi në të ardhmen mund të gjendet tek pesha e substancës narkotike të konfiskuar në vend ngjarje dhe pesha e shënuar në Raportin e Agjencisë Kosovare të Forenzikës (AKF) mbi ekzaminimin e substancës narkotike. Arsyeja është se hetuesit dhe forenzika, substancat narkotike i peshojnë ashtu si konfiskohet pa iu hequr mbështjellësi, kurse në AKF matet vetëm pesha e substancës narkotike pa mbështjellës. Mirëpo, AKF këto ndryshime i dokumenton në raportin e tyre me shkrim.</i>	<i>Menjëherë</i>